



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 213-722  
Fax:: +381 38 213-990  
e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)  
web: [www.akreditimi-ks.org](http://www.akreditimi-ks.org)

Nr. 486/13 dt. 08.07.2013

Në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7 (pika 2.3 dhe pika 4), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e BPrAL (nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e AKA-së (nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka shqyrtuar raportet e ekspertëve të vlerësimit dhe në bazë të rekomandimeve, në mbledhjen e mbajtur më 3 Korrik 2013, ka marrë:

## V E N D I M

I. Zgjatet periudha e akreditimit në nivel institucional të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2012-30 Shtator 2015).

II. Zgjatet periudha e akreditimit të programeve të studimit:

- Administrim Biznesi (BA)
- Administrim Biznesi (BA) në gjuhën boshnjake
- Kontabilitet dhe Financa (BA)
- Kontabilitet dhe Financa (MA)
- Administrim Biznesi (MA)
- Administrim Biznesi (MA) në gjuhën boshnjake
- Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë (BA)
- Juridik i përgjithshëm (LLB)
- Teknologji e Prodhimtarisë Bimore (BSc)
- Agro Ekologji dhe Agro Mjedis (BSc)

për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2012-30 Shtator 2015).

### III. Programet e studimit:

- Menaxhment në Turizëm (BA) në Gjuhën Boshnjake
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (MSc)

akreditohen për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013-30 Shtator 2016).

### IV. Programet e studimit:

- Edukim në Muzikë (BA) R
- Edukim i Përgjithshëm Muzikor (BA) R

riakreditohen për një periudhë 3 vjeçare, 1 Tetor 2013-30 Shtator 2016, me kushtin që rekomandimet e dhëna nga ekspertët të plotësohen para fillimit të implementimit të programit të studimit.

### V. Programet e studimit:

- Turizëm (MA) A
- Menaxhim i Mjedisit (MSc) A
- Teknologji ushqimore (BSc) A
- Edukim Artistik në Pikturë (BA) A
- Edukim Artistik në Instrumente me Frymë (BA) A

nuk akreditohen.

VI. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjer më 1 Dhjetor 2013.

VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Dr.sc. Ferdije Zhushki Etemi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë